



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR

NJOFTIM PËR ANGAZHIMIN E EKSPERTIT TË JASHTËM

Radio Televizioni Shqiptar në zbatim të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 33 datë 31.07.2026 për angazhimin e konsulentëve të jashtëm me qëllim ndjekjen e procesit të transformimit institucional, fton të gjithë personat e interesuar të aplikojnë për angazhimin si:

“Ekspert i Jashtëm i Burimeve Njerëzore (HR)” me kontratë shërbimi

Dokumentacioni duhet të depozitohet pranë zyrës së Protokollit të RTSH-së ose aplikimit elektronik në adresën info@rtsh.al deri më 11 Gusht 2026.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatëve.

Aplikuesit të plotësojnë dhe dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:

1. Formularin e vetëdeklarimit ([FORMULAR VETËDEKLARIMI](#))
2. Fotokopje e kartës së identitetit(ID);
3. Portofol Bashkëpunimi

Kandidatët që aplikojnë duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme si dhe kërkesat e veçanta si më poshtë:

1. Kriteret e Përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar
- Të mos ketë dënime penale: Duhet të dorëzojë dëshminë e penalitetit që vërteton se nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Pa konflikt interesi: Nuk duhet të ketë lidhje apo interesa të drejtpërdrejta me OSHMA-n, me kompanitë që konkurrojnë në projekt, apo me zyrtarët e institucionit që bëjnë përzgjedhjen.
- Të jetë i regjistruar rregullisht: Duhet të zotërojë NIPT aktiv (si person fizik ose i punësuar në studio konsulence) për të faturuar shërbimin dhe për të paguar detyrimet tatimore.

2. Kriteret Profesionale dhe Eksperienca:

- Edukimi: Diplomë "Master i Shkencave" në Menaxhim Burimesh Njerëzore, Administrim Biznesi, Financë ose fusha të ngjashme.
- Vitet e përvojës: Minimum 5 deri në 10 vjet përvojë pune në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, ku përbën avantazh të ketë punuar ose bashkëpunuar me kompani të

mëdha kombëtare ose ndërkombtare dhe të ketë qenë pjesë e proceseve të rëndësishme sidomos ato që lidhen me ndryshime transformuese (ristrukturim/riorganizim etj).

- Njohuritë ligjore: Njohje e mirë e Kodit të Punës si dhe e normave/direktivave europiane në fushën e punësimit dhe mbrojtjes sociale. Gjuhët e huaja: Zotërim i shkëlqyer i gjuhës angleze

3. Dokumentacioni që duhet dorëzuar për Aplikim:

- CV e detajuar dhe letër motivimi ku shpjegohet përshtatshmëria me projektin.
- Kopje të diplomave dhe certifikatave.
- Oferta Ekonomike
- Deklaratë mbi konfliktin e interesit dhe vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.